



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04. 51222/24, më **19 APR 2024**

Kryetari i Kryeqytetit, në mbështetje të neni 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 10 paragrafi 10.1 dhe 10.2 e nenit 53 të Statutit të Komunës, si dhe duke u bazuar në nenin 11 dhe 12 të Ligjit Nr. 03/L-054 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2009 për Vulën Rrethore, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet formimi i komisionit ad hoc për zhvillimin e procedurave për arkivimin e vulës dhe marrjen e lejes për vulë rrethore për Drejtorinë e Planifikimit, Urbanizmit dhe Mjedisit, në përbërje nga:
 1. Nazife Krasniqi, Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizmit, kryesuese e komisionit;
 2. Fatos Dibra, Udhëheqës i Sektorit të Legalizimit, anëtar;
 3. Jehona Mavraj, Udhëheqëse e Sektorit të Mjedisit dhe Energjisë Efiçente, anëtare.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, komisioni është përgjegjës për zhvillimin e procedurës për arkivimin e vulës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, për shkak të ndërrimit të emërimit dhe bashkimit të dy drejtorive në një të vetme dhe zhvillimin e procedurës për marrjen e lejes për vule rrethore për Drejtorinë e bashkuar dhe me emërtim të ri, Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe Mjedisit. Po ashtu, komisioni i cekur sipas pikës 1 të këtij Vendimi, do të jetë përgjegjës për porositjen e vulës të vulëpunuesi dhe veprimet tjera të parapara sipas dispozitave të Ligjit për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës.
3. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, komisioni harton procesverbal për çdo veprim që ndërmerr.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mjedisit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

